



*Në dasmën  
e lepurshave*

LULËZIME ÇELAMI

DASMA E  
LEPURUSHAVE

Përralla në vargje

Lezhë, maj 2020

**Dasma e Lepurushave**  
ripublikim

titujt e origjinalit  
“Dasma e lepurushave” dhe “Plani top-sekret”

## Në dasmën e Lepurushave

"Na ishte seç na ishte ...",  
po e nisim si në përrallë  
por që ta diní, o fëmijë  
me të vërtetë dikur ka ngjarë.

Në pyll bëhej festë e madhe,  
aty këndohëj e hidhej valle,  
me brohoritje të gëzueshme  
bëhej dasma e lepurushëve.

Në atë lëndinë me bar të butë,  
ishin ftuar të gjithë me radhë,  
që nga kafshët më të urta  
gjer te kafshët grabitqarë.

Kishin parë s'kishin parë  
rrinin bashkë pa u ngarë.

Lepurushi bën me dorë:  
-Miq të dashur, miq dasmorë,  
Mirë se erdhët në dasmën tonë!  
Të gëzuar qofshi gjithmonë!

## Në dasmën e lepurushave

---

Sot jam i lumtur pa kufi,  
se fillojmë shekullin e ri.  
Le të vendosim në dasmën tonë  
të rrojmë në paqe përgjithmonë.

Jo më grindje e armiqësi,  
jo më frikë, por harmoni!  
Çdo marrëveshje në jetë  
mirëkuptimin zgjidhje të ketë.

Kështu foli lepurushi  
trim si ky s'ishte askushi.  
Të gjithë dëgjonin me dëshirë,  
s'mund të fliste kush më mirë.

Tek flet sytë i rrotullon.  
kë vallë ai po kërkon?  
Zemra seç i dridhet lehtë  
bodigardin me sy thërret.

Dy qen llapushë i rrinë pranë,  
e s'e prishin hiç davanë,  
shohin, pinë e gëzojnë  
ç'detyrë kanë nuk harrojnë.

Elefanti në këmbë u ngrit

---

të përshëndesë gjithë miqtë:  
-Dhëndërr fole bukur shumë  
një urim do bëj dhe unë.

Gjithë banorët e pyllit tonë  
harmoní paçin gjithmonë!  
Ujk , të uroj në veçanti  
të mos bësh kurrë ligësi!

Dhëlpres í lutem për një gjë:  
të mos dhëlpërojë në jetë më!

Ngritën gotat që të gjithë,  
dhe mes tyre ca urithë,  
po shikonin me çudi.  
“Ç’që gjithë kjo mrekulli?”

Dhe vazhdonin të ngrinin gota,  
le të çuditëj e gjithë bota!

Kishin parë s’kishin parë,  
rrinin bashkë pa u ngarë.

Ja, papritur pushoi muzika,  
dhëlpres gati í ra pika,  
kur para saj gjithë lezet,

---

del një gjel si dirígjent.

Veshur bukur e stolísur  
dirígjímít ía ka nísur.  
Në kor pulat po këndojnë  
fillojnë dhëndrrín të urojnë.

Vetëm dhelpra s'mbahet dot,  
në fshehtësí ujkut í thotë:  
-Të keqen ujke, të bëj ríxha,  
veç një pulë më lër të ha.

-Lëri fjalët! - ujku tha,  
asnjë punë të hajë s'e la.  
Ah, mbetí dhelpra pa kokosh,  
ç'po í djeg stomaku bosh!

Bëri, ç'bëri e duroi  
por oreksí s'í kaloí.

Asnjë çast të qetë s'e lanë  
se një zog í erdhí pranë.

Lëpin buzët dhelpra skíle  
e filloí të flasë me híle:

-Zog i vogël laraman  
sa i bukur po më ngjan!

S'ka një zog si ti në pyll,  
vërtetë qenke një zog yll.

Afrohu pak më përqafo,  
se ty tezja fort të do.

Por dhelpira, lajkat i ndërpreu  
se në kurriz një dhembje ndjeu.

E kuptoi skëlja dhelpër  
e kish goditur ujku me kthetër.

Ujku thirri gjithë inat:  
-Lëri hilet moj e ngratë!  
Zogu mbeti i habitur  
nga biseda që dëgjoí,  
ciu -ciu trembshëm thirri  
e drejt nënës së tij shkoí.

Dasma kulmim kish arritur  
gjithë dasmorët ishín ngritur.

Nisën vallen që e príu  
me hap të rëndë krushkë aríu.



vallëzonte lehtë ketrushí,  
íso mbante dhe drenushí,  
ja majmuní hídhej hopa,  
pak më tej pëlliste lopa.

Gjithë bilbilat këngëtarë  
këngëtarë me zë të rrallë  
na kríjuan një símfoní  
të dírigjuar për mrekuí.

Befas kalí tundi kokën  
dhe me këmbë shkërmítí tokën,  
híngëlliu me zë të hollë  
të gjithë pyetën: "Çfarë ka ndodhë?"

-Mos u trembni! - folí kalí  
dhe pak më tej sytë í ndalí.  
Aty ísh një gjel í rrallë,  
gjel më të bukur s'kíshín parë.

Kalí bëri prezantímín  
për ta njohur mysafírín.  
-Ky është gjelí Alesmag,  
që ka ardhur nga shumë larg.

Gjithë dasmorët hapën sytë

---

s'kishin parë kurrë këtu  
një gjel të madh, aq të bukur  
puplaverdhë, kuq e blu.

Nuk vonoi dhe kikiriku  
me rrahje krahësh përshëndeti  
me një zë të dredhur thirri  
nga mallëngjimi dhe respekti.

-Mirë se ju gjetëm o dasmorë!  
Kemi ecur tridhjetë orë  
që sot të jemi bashkë këtu  
me shokun tim kecin Dudu.

Keci ndryshe ishte,  
shumë nur e bukurí kishte.  
Ishte i madh e plot shëndet  
ngjyra gri i kishte lezet.

-Ju falënderojmë për nderimin  
që na bëtë duke na ftuar.  
Do kalojmë çaste dëfrimi,  
lehtë s'kanë për t'u harruar.

Ne s'e dinim në të vërtetë

---

që këtu bëhet tjetër jetë.  
Gjithmonë e paçi o miqtë e mi,  
këtë gëzim e harmoni!

-Meee, meee, meee - keci thirri,  
aq sa zërin krejt e ngjirri.

-iaaa - iaaa, - një zë i fortë,  
na buçiti si një trombë.

S'ishte trombë, por gomari,  
përshtëndeste dhe veshëgjati.

-E vërtetë, e vërtetë  
Këtu është tjetër jetë.

Pak më tutje zonjës dhelpër  
mesa duket fati i qeshi  
"I duruari, i fituari!"  
i foli lehtë ujkut te veshi.

Duke hequr bishtin zvarrë  
drejt gjelit shkoí ngadalë,

Gjeli e priti me një dollí  
rrezatonte plot hijeshi.

---

Pastaj e pyeti ëmbël, ëmbël:

-Deshe gjë zonja dhelpër?

-Ah, i dashur mi ku im,

a mund te vini ne vallëzim?

Të gjithë shihnin duke qeshur  
si vallëzon gjeli me dhelpër.

Çumëzhin përreth rrëmuja  
ujku shkoí te kec Duduja.

u takuan e biseduan  
dhe sa shpejt u miqësuan.

Tokën bashkë këmbët e para  
dhe papritur plasí vallja.

Bëhej dasmë e #'dasmë se!  
Këngë e valle plot hare

ujku e keci vallëzojnë tok  
porsi miq të mirë e shokë.

Me sa forcë në bar kërcenin  
Lodhjen fare nuk e ndjenin.

Por, papritur miqtë tanë  
vallëzimin pse e lanë?

Ç'patí ujku, ç'patí kecí?  
Ku shkoí dhelpra, ku vajti gjeli?

Asgjë e keqe s'kishte ndodhur,  
nuk u ndanë pse ishin lodhur.

Gjelin e kishte marrë etja,  
me sa gëzimí i foli dhelpra:

-S'është problem o miiku im,  
të çoj unë te një burim.

Me shkathtësí sí e ka zakon  
gjelit rrugën í tregon .

E pas tyre ujku me kecin  
ecnin bashkë, flasin e qeshin.

Kaluan një rrugë, pastaj një tjetër,  
iu hodh gjelit skilja dhelprë.

Dhe ujku qeshí:- Ha - Ha - Ha!  
Bëhu gatí kec të t'ha!

---

Por nuk guxuan të hidhen në sulm,  
se u dëgjua një hum - hum - hum!

Atëherë dhelpira sa s'u çmend  
kur pa që gjeli ishte bërë qen.

Edhe ujku sytë fërkoí  
Kur në vend të kecit qen shikoi.

Me ham - ham e hum - hum - hum  
gumëzhíu pyllí i pafund.

Keci, ujku, gjeli e dhelpira  
luftuan gjatë me dhëmbë e kthetra.

Po cilët ishin fitimtarë?  
Dhelpira íku me bisht ndër shalë.

Keci shndërruar në langua  
e hodhi ujkun në përrua.

Në këtë ngjarje të paparë  
dasmorët ishin dëshmitarë.

u ngrít e folí një arí:

---

## Në dasmën e lepurshave

---

-Me ujë e dhelpër s'ka miqësi!

Ju lumtë, ju lumtë të dyve  
që na i shporrët larg syve!

Tani miq e shokë të shtrenjtë  
dasmën ta vazhdojmë të qetë.

Le ta ngremë me fund një gotë  
çifti ynë u trashëgoftë!  
Kení parë s'kení parë,  
kjo me të vërtetë ka ngjarë.

Në një dasmë të vërtetë,  
ujë e dhelpër s'mund të ketë.

## Në kërkim të famës






Na ishin pesë kopsa të kuqe  
të bukura si mollëkuqe  
me dy pika të zeza në mes  
që luanin bashkë çdo mëngjes.

Gjatë ditës që të pesta  
luanin, qeshnin si në festa  
te shkëlqenin si rubinë  
ia shtonin xhupit bukurinë.

Një ditë krejt papritur  
pushoi loja dhe gëzimi  
shkaku ishte një lëvizje  
që u bë nga nxitimi.



Kopsa e fundit pa përtim  
i pa shoqet me zemërim  
nuk e mbajti veten dot:  
-Pse, unë qenkam këtu kot?



-A nuk jam dhe unë si ju  
një kopsë e xhupit tonë blu?  
Kur më lënë pa mbërthyer  
unë ndihem shumë e fyer.

-S'kam përse t'ju kem zili  
edhe unë kam bukuri  
po të isha unë e para  
s'do dëgjonit kurrë të qara.

Shoqet panë me dyshim:  
Çështë vallë ky mendim?  
Se ku je s'ka rëndësi.  
Ç'kupton ti me rehati?

-Kopsë e parë të kam zili  
atje lart sa mirë që je!  
Dhe... sa hap e mbyll sytë  
ajo ra në dysheme.

- Oh, sa mirë, oh, sa bukur!  
- thirri kopsa e këputur.  
Kësaj i thonë vërtet liri  
do t'i bie gjithkujt në sy.

Do të bëhem një Showstar  
do më vijnë plot gazetarë  
do kërkojnë të dinë për mua  
e do t'u them ato që dua.


Do jap spektakle pambarim  
fama dhe shkëlqimi im  
do të kenë duartrokitje  
do të jenë gjithnjë në rritje.

Ja, kështu symbyllur kopsa  
fliste, qeshte, ëndërronte  
O, bo-bo, mendjeboshja  
nuk e dinte çfarë kërkonte.

U mundua secila shoqe  
ta largojë nga ëndrrat kote  
por u lodhën kot ato  
e ku merrte vesh ajo!

U largua me hap të lehtë  
fluturoi lart me mendje  
Shoqet thanë: - Si t'ia bëjmë  
ta shkëpusim nga kjo çmendje?

Eci ndoshta plot një orë  
në rrugën plot kalimtarë  
që nxitonin, veç nxitonin  
thua se po bënin garë.




Kopsa shihte e habitur,  
dukej krejt e çoroditur  
askush atë s'e vinte re,  
dukej se nuk kishin nge.

Nuk shkoi gjatë kjo çoroditje,  
e ndaloi në çast një dhembje  
në kurriz aq fort e ndjeu  
sytë gati sa s'i shqeu.

Kopsa thirri: - O le le!  
Ç'faj bëra? – dhe rënkonte.  
Një makinë kaq e madhe  
mbi mua gjeti të kalonte?!

Iu ngrys balli nga trishtimi:  
-Oh, më iku gjithë shkëlqimi!  
Sa shumë pluhur ra mbi mua  
dhe bukuria mu shëmtua.

Në fytyrë i rrjedhin lotët  
dhe i bien në trotuar,  
pastaj nisi të kujtohet  
çfarë ëndërronte pak më parë.



Dhe më pas i fshiu i lotët,  
iu kujtuan katër shoqet,  
ëndërroi t'i prijë e mbara,  
të nisi jetën nga e para.

Për një çast i erdhi fati  
tek po ecte çalë-çalë:  
-O sa mirë, gjeta një kopsë!-  
pranë saj thirri një djalë.

Por fati nuk i zgjati shumë,  
se djali gjeti disa shokë  
e filluan të luajnë me kopsa  
të bashkuar kokë më kokë.

Shumë gjatë vazhdoi loja,  
o sa tmerr hoqi e gjora  
kur e hidhnin pa mëshirë  
duke sharë e duke thirrë.

Dhe nga djemtë zhurmëtarë  
u dëgjua një zë i çjerrë:  
- Pse kështu moj Showstar  
do shkëlqesh mbi të tjerë?!

Fërkoji sytë gjithë pluhur  
për të parë në largësi.  
-Kush do të jetë vallë ai  
që më flet me ironi?

Mezi shihte, se shikimin  
ia pengonte shumë loja,  
dhe dalloi një kopsë të vogël  
që i kishte dalë krejt boja.


-Po ti qenke moj mistrece!  
Lëri fjalët, gojën qepe!  
Dhe pse ishte shumë e lodhur  
donte krejt ta kishte ngordhur.

Por vazhdoi prapë t'i thoshte:  
-Pa dëgjo ti vogëlushe,  
çfarë kërkova unë në jetë  
ty s'të duhet, e di vetë!

Kopsa e vogël nuk shau fare  
foli lehtë me dhembshuri:  
-Ti nuk sheh sa poshtë ke rënë,  
sa më vjen keq për ty!

Si ti kërkova dhe unë lavdinë,  
lashë larg shoqet e shtëpinë  
shiko si jam bërë e mjerë  
s'dua të shoh kështu të tjerë!





Kopsa mbeti e çuditur,  
këto fjalë s'i kishte pritur  
dhe i kuptoi shpejt e drejt  
gabimet që kish bërë në jetë.

Nga sytë çurg i rrodhën lotët,  
iu kujtuan katër shoqet  
që kishte lënë te xhupi blu  
“S'kam ç'të bëj më këtu!”

Ah, këta çuna harrakatë,  
me përplasnin poshtë e lart,  
të gjithë tallen me mua,  
dhe bukuria mu shëmtua.

Prapë lotuan sytë e saj,  
kopsa e vogël tha: - Mos qaj!  
S'do shkëlqim, as bukuri  
kur ke shoqe dhe shtëpi.

Kush është shoqe e vërtetë  
ty të do kështu si je  
po kur punon mirë në jetë  
shumë më tepër vlerë ke.

Asnjë fjalë s'e foli kopsa,  
falënderoi vetëm me sy,  
fytyra e saj sikur thoshte:  
“S'të harroj kurrë ty...”

Tani s'ndihej më e qetë  
ndërsa brenda digjej furrë  
me vete thoshte këto fjalë:  
“Më mirë vonë, se sa kurrë.”

## Cili është kryetari?

Filloi debati në mbledhje  
për të zgjedhur një kryetar,  
marrin pjesë desh e dele  
dhia, qengja, një gomar.

-Unë - tha i pari Dashi  
me brirët harkuar përpjetë -  
për forcë jam i pari  
dhe kam qenë i pari përjetë.



-Kundërshtoj - thirrri Cjapi  
me mjekër të ghjatë, të bardhë –  
se kush është më i fortë  
ne duhet të bëjmë garë.

-Ju lutem! – u ngrit Laroshja  
që kishte ndenjur te qoshja  
ajo shquhej në atë sallë  
se kishte një bukuri të rrallë.

Tani, do të bëj dhe unë  
një propozim të mençur shumë,  
të zgjidhet i parë vetëm ai  
që na e kalon për bukuri.

-Meeeeee, – e mori fjalën dhia  
ajo dallohej nga mençuria. -  
Nuk të thërrasim më Laroshe,  
do të quajmë Kokëboshe.

Ç'thua moj, e shkreta ti!  
Boooo-bo-bo, ç'është kjo habi?!  
Dorën përplasi fort në ballë:  
Këto s'ndodhin veç në përrallë.



E ngjiri zërin, mjekrën nduku:

-Ah, sikur të isha ujku!

Do kërceja tek ajo qoshe  
e do të shqyeja moj Laroshe.

Unë s'bie poshtë nga bukuria,  
s'më dhemb stomaku, as mëlçia,  
njëlloj si ti në lëndinë  
kullos lulet trëndelinë.

Më pas Laroshja qëndroi heshtur,  
ndonjëri tallej duke qeshur,  
por dhia prapë e mori fjalën,  
me zë të lartë e tundi sallën:

-I pari mund të jetë vetëm ai  
që s'ka veç forcë e bukuri,  
por të ketë në veçanti  
dhe zgjuarsi e dashuri.

U dëgjuan shumë duartrokitje  
që shprehnin hapur miratim,  
por ndonjëri s'desh t'ia dinte  
për gjithë këtë entuziazmim.

-Unë, i pari – tha Dashi -  
le të mbyllet debati -  
ja mungon vetëm vula  
se gjithçka është gati.

Ai ngriti lart një letër,  
me shkathtësi u hodh si ketër,  
të gjithë shikonin duke heshtur  
dikujt i vinte për të qeshur.

-Be-be-be-be-be-bee!  
Zoti Dash të drejtë nuk ke,  
por ti akoma nuk e di  
ç'do të thotë demokraci.



Që ta dish i dashur Dash  
ndryshon formula e krijimit  
s'mund të rrimë vetëm ne  
jashtë epokës së ndryshimit.

Ky ishte zëri i qengjit,  
qengjit të vogël lara-lara  
por qetë-qetë e ngadalë  
seç i zuri vend fjala.



Atëherë Dashi gojë nuk hapi  
e kuptoi se qe e kotë:  
-Më mirë tha le të shpresojmë  
se mos marrim ndonjë votë.



Plot një javë shkuan votimet  
duke shpifur, duke sharë,  
por s'janë shpallur rezultatet  
cili do të fitojë vallë?





## Djali dhe lulet

Plot lule shumëngjyrëshe  
jetonin bashkë në miqësi  
dhe secila prej tyre  
rrezatonte hijeshi.

 Shkëlqimi i tyre  
të përkëdhelte në shpirt   
dhe gjithë gjërave përreth  
u jepnin jetë e dritë.

 Ato lule fëmijët   
i shikonin me ëndje  
dhe u pasqyrohej në sy  
një ndjesi e këndshme.


 Pranë tyre një ditë   
u afrua një vogëlush  
kish fytyrë të praruar  
në dorë mbante një arush

-O Arush, më prit mua  
të shoh lulet se i dua.

Sa të bukura janë!  
Ç'aromë të mirë kanë!

Dhe vogëlushi u afrua  
i përkëdheli lehtë ato,  
lulet sikur e pyesin:  
-Ti, cilën më shumë do?

Gjithë luleve me radhë  
erë ngadalë u mori,  
por asnjëra prej tyre  
aromë fare nuk nxori.



-Mos jam ndoshta sëmurë?-  
pyeti djali kokëulur  
dhe shikimin ia nguli  
një zambaku të bukur.

-Eh, moj motërzat e mia!-  
u ankua ai zambak-  
ne s'na jep kush të hamë  
nga mëngjesi në darkë.





Dhe po s'hëngre asnjëherë  
nuk mund të kesh aromë,  
kështu si na kanë bërë  
do të jemi gjithmonë.

Djaloshi fërkoj sytë  
i çuditur nga kjo pamje:  
-Pse, dhe lulet kanë vuajtje  
dhe lulet paskan halle?

Një karafil pëshpëriti:  
-O zambak, dëgjomë!  
A do të kishe dëshirë  
të lëshoje pakëz aromë?

U shtang prapë vogëlushi  
s'mund të besonte kaq lehtë  
vendosi mos të largohet  
ta dëgjonte këtë bisedë.



-Ëëëëë, - nënqeshi zambaku -  
ne s'duhet të harrojmë  
se bukuria e ngjyrave  
na qëndron gjithmonë.

-E di – ia priti karafili,  
por më quajnë artificial  
sa do të doja në jetë  
të isha dhe unë natyral.

Të isha një lule lëndine  
që ushqehet nga toka  
të më përkëdhelte dielli  
me ato rreze të ngrohta.


Kur etja të më marrë  
do më japin ujë të pi  
me petalet do të shpërndaja  
aromë dhe shumë freski.

Ky vogëlush që kam përpara  
do më merrtë lehtë erë,  
me bukurinë e vërtetë  
do krenohesha çdoherë.

- Jo more, – tha zambaku-  
ç'na thënke o i shkretë,  
nga gjithë petalet e tua  
s'do të mbetej një fletë.

Gjithë lulet natyrore  
vyshken pas një viti,  
kurse ne jetojmë  
dhe më gjatë se lisi.

Por karafili qeshi:  
-O ti zambak, dëgjomë!



Ç'na duhet bukuria  
kur nuk fal aromë?

Më kot bëjmë replika  
kështu do jetojmë,  
si na bëri fabrika  
fatin s'ë ndryshojmë.

Vogëlushi e dëgjoi  
bisedën i trishtuar  
dhe iku i mërzhitur  
me arush në duar.



## Plani Top Sekret




Deti me ngjyrë të kaltër  
shpesh ndërron fytyrë,  
herë ngryset nga stuhia  
herë shkëlqen si pasqyrë.

Keni parë si turret dallga  
duke shfryrë me shkumë të bardha,  
sikur bën me shoqet garë  
kush arrin te bregu më parë.



Deti ngjan si gjë e gjallë  
ai na flet me dallgë e valë  
për mijëra ngjarje, o fëmijë,  
që kanë ndodhur brenda tij.

Dhe në ujët pranë bregut  
ku bëni not e lozni ju,  
plot gjallëri lëvizin peshqit  
këta banorë të detit blu.



Pak më tutje në këtë çast  
u thotë shokëve peshku Bas:  
-Uaaaaaa, shikoni sa çudi  
këtu paska plot fëmijë!

Ndaloni pakëz të vini re  
këta notokan porsi ne!  
Por peshku Bas foli gjatë  
dhe peshku Fap mori inat.

Me zemërim e shikoi Basin:  
-S'kemi kohë të humbasim  
more vesh, po fole shumë  
do të hash një grusht nga unë!

Tufa e peshqve të tjerë  
i dëgjoji fjalët menjëherë  
u trondit nga kjo ngjarje  
s'ishin mësuar kurrë me sharje.

Prandaj ai që quhej Krap  
i bërtiti peshkut Fap:  
-Në tufën tonë mbaje mend  
kërcënimet s'kanë vend!



Ato fjalë që i the Basit  
mos i nxirr nga goja më,  
në gjithë detin tonë të kaltër  
të jetë miqësia mbi çdo gjë.




Nga më i madhi te më i vogli  
të gjithë Fapit i shkuan afër,  
disa lehtë e këshilluan  
ca të tjerë i folën ashpër.



Pas vendosjes së qetësisë,  
secili u nis në punë të vet  
se qëndrimi i gjatë aty  
me rrezik mund të jetë.

Në thellësi të detit tonë  
dhe ngjarje të rënda ndodhin,  
një fjalë e urtë na mëson:  
“Peshku i madh e ha të voglin”.

Po peshku Fap ç’pati vallë  
që po ecën kaq ngadalë?  
Në fund të ujit ai ka parë  
diçka të ndritshme porsi ar.



Prandaj shkoi pak më thellë  
që ta kapë me gojë lehtë,  
këtë send kaq të verdhë  
donte ta gëzonte vetë.

Por arriti veç ta prekë  
për ta marrë nuk mundi dot,  
dikush bishtin ia kafshoi  
-Ndhmë, ndhmë! – thirri fort.


Atëherë tufa e kuptoi  
që ai ndodhej në rrezik,  
dhe nxituan ta ndihmonin  
se të gjithë e kishin mik.

Peshku Fap që bërtiti  
gati kish filluar të qajë  
Gloni ia tërhiqte bishtin  
sepse donte që ta mbajë.

Të gjithë shokët u bënë hark,  
zunë një pozicion luftimi,  
si armë lufte në këtë rast  
do përdorej veç hutimi.

E gjithë tufa menjëherë  
filloi lëvizjet: Një-dy-tre!  
Baçi, Fapi, hej, sambo  
sambo, sambo kërcejmë ne.

Atëherë dhe Gloni grabitqar  
e drodhi trupin shumë krenar  
dhe gojën e hapi me një: “Oh,  
ky kërcim shpirtin ma ngroh!”



U përpoq të imitonte  
lëvizjet e tyre me kujdes  
dhe në mendje nuk i shkonte  
se nuk kishte ngrënë mëngjes.


Vazhdonte Gloni i gëzuar  
nën ritmin e kërcimit,  
kjo sambo qenka e ururar  
dhe si mjet i shpëtimit.

Peshqit shumë ishin dëfryer  
ndaj u larguan duke kërcyer  
të gjithë bashkë radhë-radhë  
notonin tani pa bërë fjalë.

Eh, po Fapi është hutuar  
ajo ngjyrë e ka verbuar.  
Shpejt thurri planin Top Sekret  
do ta realizonte vetë.

Priti, priti sa u err  
u maskua, por iu duk tmerr  
Befas kokën ktheu pas  
prapa ishte peshku Bas.





I erdhi në kokë për çudi  
fjala “Bashkimi bën fuqi”  
ndaj ftoi Basin në detyrë  
e maskoi si s’ka më mirë.

Nën guacka me guxim  
nisën bashkë këtë udhëtim.  
Pranë vendit strategjik  
panë Glonin, peshkun armik.

- Ë ë ë – dëgjuan një zë të lodhur,-  
ja ku erdhe përsëri,  
do të doja të kisha ngordhur  
në mëngjes kur ike ti.

-Jo të lutem – thirri Fapi,  
se Gloni përsëri e kapi.  
-Erdha se më mbeti merak,  
sambon e mësove ndopak?!

-Sambon e kërcej mrekuilli  
mos ma mësove vallë ti?!-  
iu përgjigj Gloni menjëherë  
s'ish zë i lodhur, as i çjerrë.

Dëgjohet një zë i bukur, plot melodi  
Gloni kthen kokën me habi  
Basi këndonte hidhej, dy tre:  
-Jam i fortë në karate .

-Ah, i dashur peshku Glon  
nuk bën mirë që vetëm shikon  
kërce me mua, ja: një, dy tre,  
e duam sportin karate.

I çmendur pas kërcimit  
Gloniu u vu shpejt në radhë  
imitonte lëvizjet e Basit  
dhe këndonte, ndonjë fjalë.


Kërcente këndonte Basi  
nga lodhja sa nuk plasi  
shikonte Fapin sipas planit  
ia kishte frikën Glonit.

-Bukur, bukur, i dashur Glon  
mbyllen sytë te refreni.  
Ej ju peshq, ja shikoni  
kërcimtar si ky a gjeni?

Tani ishte kulmi i planit,  
rrethin ia morën Glonit.  
Gloni kërcente në ëndërrime  
i mësoi sot dy kërcime.

Të dy notuan si të marrë  
ndjenin këngë brenda tyre,  
me vullnet dhe shumë guxim  
i dhanë fund kësaj detyre.

Treguan të dy në mëngjes  
se si ia hodhën Glonit  
shokët panë rrethin me kujdes  
“A ishte ai sukseasi i planit?!”



Atëherë shumë mendime  
në breg u nisën me mision  
ky rreth të shkojë duhet  
nëvendin që i takon.

E hodhën rrethin në breg  
u kthyen tok në qetësi  
-Tani plani korri sukses -  
me zë të prerë foli Basi.

-Po, po ky është suksezi  
i planit tuaj Top Sekret  
pasi nga zgjuarsia juaj  
gëzim dikush do të ketë.

Këto fjalë peshqve të vegjël  
ua tha deti babaxhan  
ai që me shumë dashuri  
në gjirin e vet ata i mban.

Buzëqeshje kudo tani  
detit më shumë i qesh fytyra  
ngjarje të tilla brenda tij  
e bëjnë të shkëlqejë si pasqyra.

## Përmbajtja

Në dasmën e Lepurushave .....	4
Në kërkim të famës .....	16
Cili është kryetari?.....	27
Djali dhe lulet .....	33
Plani Top Sekret .....	41